

NATYRA NË SHSTATË PASQYRA (“PASQYRAT E NARÇIZIT”)

Esma DODAJ¹

¹ Department of Literature, Faculty of History and Philology, University of Tirana

*Corresponding author e-mail: esma.dodaj@yahoo.com

Përmbledhje

Gjithçka që mund të shihet në planin e temës të “*Pasqyrat e Narçizit*” (1936), është kërkimi i identitetit artistik, të cilin Koliqi e gjen të plotë veç në fund, duke i krijuar edhe vetes qetësimin e kahershëm shpirtëror. Shtatë pasqyrat, të cilat për nga kodi tematik dalin si variante të njëra-tjetrës, japin qartë shtatë mënyrat e kërkimit nëpërmjet rrënjëve, traditës, vlerave kulturore, gërshtimit të së kaluarës me të tashmen si raport i ri kronotopik, simbiozës së realiteteve e mentaliteteve, rrëfimeve të përfuara prej procedimit të kujtesës, ndërthurjes së zërit të jashtëm me atë të brendshëm, etj., që kanë një rol të rëndësishëm në këtë vetëshpërfaqje dhe vetëzbulim të autorit-arrator.

Në këtë vepër, Ernest Koliqi shpalos shpirtin e tij në shtatë variante. Ai e realizon këtë nëpërmjet lojës së tij me zërat narrativë, me simbolet, me mitin, me metaforën, etj. Këtu ka një rol të rëndësishëm edhe natyra, të cilën do ta shohim në lidhje me narracionin; përshkrimin si stil ku do të hetojmë rrafshin simbolik, si dhe përdorimin e hipotipozës; strukturën kompozicionale të teksteve, etj.

Rrjedha e ujit strukturon poemthat në prozë, së cilës në nivel simbolik i përgjigjet rrjedha e gjakut shqiptar dhe ajo e limfës bimore. Kështu, do të shohim sesi metamorfoza bimore merr trajtën e rrëfimit. Duke pasur parasysh teorinë narratologjike, do të paraqesim sesi realizohen funksionet e përshkrimit të natyrës në vepër: ai dekorativ, shpjegues dhe simbolik.

Fjalë kyçe: natyra, narracioni, përshkrimi, hipotipoza.

Nëpër “pasqyra”

“Pasqyrat e Narçizit” përbëhet nga shtatë poemtha në prozë në këtë renditje: “Ujët e pusit”, “Pasqyrë e vjetër shkodrane”, “Kroni i Bardhanjorvet”, “Prrue në Dukagjin”, “Nji çuterr në Helveti”, “Vala e detit” dhe “Xhami i dritores s’ime”. “Pasqyrat e Narçizit” si jetëshkrim, ndërlihet me procesin krijues dhe kërkesën e autorit për njohje apo rinjohje kulturore e shpirtërore, e cila kalon nëpër një proces, duke filluar nga jeta e hershme e ardhur si kujtesë e një ëndërrimtari, që shpërthen në momentin krijues për të shkruar një tekst, një lloj autobiografie poetike në bazë të kujtesës, ku nostalgjia, e djeshmja dhe e tashmja, përfytyrimet, reflektimet dhe luhatjet e mendimeve, shfrytëzohen nga Koliqi për t’u shkrehur maksimalisht në ekstremet e vetëdijes dhe nënvetëdijes për krijimin e autoportretit të tij, nga lidhjet e tij me truallin amtar deri në tërheqjen ndaj hapësirave të reja, lirisë së pakufishme.

Struktura e rrëfimit të shtatë pasqyrave është e tillë: rrëfimin e marrin përsipër dy zëra që dialogojnë në tekst dhe ata janë:

“1. Narratori në vetën e parë, që në nivel të subjektit është personazhi i poetit.

2. Narçizi, narrator në vetën e dytë që, në nivel të subjektit është personazhi i zërit të poetit.

<https://doi.org/10.62792/ut.albanologjia.v11.i21-22.p2593>

Këtë mundësi e përmban vetë miti i Narçizit, vetja e pasqyruar në pasqyrë dhe dialogimi i këtyre dy zërave (vetave) strukturon rrëfimin e "Pasqyrave të Narçizit".¹⁵⁶ Pra, zërat që marrin përsipër rrëfimin, teorikisht mbeten narratori në vetën e parë dhe narratori në vetën e dytë. "Ndër dy zërat njëri, narratori në vetën e parë, poeti, rrëfen, ndërsa i dyti, narratori në vetën e dytë, zëri i poetit rrëfëhet. Ky rrëfim i dyfishtë para "pasqyrës" që i ridimensionon të dy zërat është gjithë ngjarja e "Pasqyrave të Narçizit".¹⁵⁷ Funkzioni i pasqyrës/pasqyrimit në tekst, paraqet kontradiktën ndërmjet pamjes (aparencës) dhe thelbit të brendshëm, esencës së njeriut.

Përmes zërit rrëfimtari, poeti arrin të zbulohet, pra të "shihet" së brendshmi dhe i shtrohen përpara koha e hapësira që dallojnë dhe diferencohen nga e zakonshmja dhe realiteti, deri sa ngjarjet futen në përmasat e një rrëfimi tjetër që turbullon. Pasqyra reflekton gjithçka që hyn në rrezen vizuale të saj, e bën këtë në mënyrë spontane, të pavullnetshme, pasive, të padepërtueshme, të heshtur, aq sa narratori, personazhi i poetit, bashkon imazhet që vrapojnë rrotull tij me ëndrrat, vizionet, përfytyrimet që lidhin kohët mes tyre.

Është pikërisht kujtesa ajo që depërton në jetën tonë të përditshme duke futur brenda mendimeve tona atë çka ka mbetur nga fëmijëria jonë dhe nga fëmijëria e njeriut në tërësi, duke na shtyrë në këtë mënyrë të kalojmë, pa e kuptuar as vetë, nga kepi i së njohurës drejt brigjeve të së panjohurës. Në vijim të kësaj, mund të themi se te "Pasqyrat e Narçizit" simbolet e tilla reflektuese si uji, qelqurinat apo pasqyrat, kryesisht lidhen me të kërkuarit, zbulimin e qenies, të subjektit. Nga një anë tjetër vërehet stadi jetësor i fëmijërisë.

Fëmijëria është periudhë reflektimi për narratorin. Përmes rikthimit në atë moshë por edhe në hapësirën, ambientin që e identifikon atë moshë dhe kohën reale të asaj periudhe, autori evokon të kaluarën. Nëpërmjet saj ai kthehet sërish te tema qendrore, kërkimi i pasqyrimit, njohjes së vetvetes dhe përmes kësaj edhe te zbulimi e krijimi i poezisë, i identitetit krijues. Koliqi e rikrijon të kaluarën kryesisht i nxitur nga ndonjë detaj i së tashmes, i cili shërben si indicie për rikthimin e së shkuarës.

Detajet e tilla dhe forca e tyre reflektuese, që e rikthejnë ndjesinë e përjetuar në një situatë të caktuar, e sjellin ngjarjen jo thjesht si një kujtim, por e bëjnë motivueshëm pjesë të së tashmes. Pra, rrëfimi për të shkuarën përjetohet i afërt, sikur të ndodhte në të tashmen. Kjo arrihet përmes kujtesës së pavullnetshme (choc-u, term ky i teorive letrare moderne që personifikon rastin kur kemi të bëjmë me shkrirjen e së tashmes me të shkuarën). Zëri narrativ jep dëshmitë e refleksionet emocionale, pa e saktësuar kohën e ngjarjes e as hapësirën konkrete, kështu që koha narrative e përdorur krijon efekte të njëpasnjëshme poetike, duke mos zbuluar asgjë.

Te "Pasqyrat e Narçizit" shpesh fillohet me përshkrimin e ndonjë detaji, i cili zakonisht përdoret në funksionin e rikthimit të çasteve të së kaluarës, të cilat shërbejnë për ta ndërprerë rrjedhën reale të kohës, ndërsa pikërisht detaji i përdorur rikthen historinë dhe përmes saj edhe gjendjen emocionale të atij momenti të reflektimit. Pra, kapërcimet nëpër kohë nxiten shpesh edhe nga detajet apo nga diçka në pamje të parë e parëndësishme, por që shkaktojnë me shumë afinitet, ndryshime në ndërgjegjen e narratorit. Nisur nga "Kroni i Bardhanjorvet", studiuesi Kujtim Shala shprehet se në këtë vepër gjithçka është kujtim. Autori e sheh veten prapa në kohë, tashmë si personazh të asaj që e rrëfen, thotë Shala.¹⁵⁸

¹⁵⁶ Dhurata Shehri, "Koliqi mes malit dhe detit", fq. 22

¹⁵⁷ Po aty, fq. 23

¹⁵⁸ Kujtim Shala, "Shekulli i letërsisë shqipe", fq. 47

Estetika e natyrës

“Natyres, në funksionet e saj normative i njihen shumë kuptime (rreth gjashtëdhjetë) që derivojnë nga emërtimi mbi të jashtmen (natyra e gjallë) deri te referimi si pjesë e brendshme e njeriut. (sjellja, individualizmi human)”¹⁵⁹ Në zhvillimin e konceptit “natyrë” brenda rrymave të ndryshme të mendimit letrar apo filozofik, natyra ka pasur “kundërshtaret” e saj me të cilat është përballur sipas konteksteve të caktuara. Shpërthimi poetik me natyrën si subjekt lulëzoi në romantizëm si kundërshti ndaj qëndrimit të klasicizmit e neoklasicizmit, duke u thelluar në teoritë e lidhjes njeri-natyrë. Romantikët e intiman, e subjektivizuan atë, ndërsa në lëvizjet e mëpasshme natyra mori karakterin e dinamikave të kohës.

Natyrë te Koliqi është e pranishme gjithmonë me rol aktiv. Ajo është pjesë integrale e krijimeve të tij në përgjithësi dhe e “Paqyrave të Narçizit” në rastin tonë konkret, e cila më së shumti vjen si një instrument për t’u përballur me gjendjen e narratorit-poet në sinkroni apo kundërshti me një gjendje apo ndjenjë. Ajo vjen edhe si identifikuese simbolike e shpirtit. Këto qasje varen nga konteksti poetik. Kështu, te “Paqyrat e Narçizit” natyra shfaqet me tërë butësinë dhe gjallërinë e vet, duke u bërë pjesë e së bukurës komplekse eksternale, e cila luan rolin e bashkëshoqërueses ose kontrastueses në lidhje me subjektin e përzgjedhur poetik, qoftë personazh, qoftë koncept siç është jeta, vdekja, e shkuara, e ardhmja, kërkimi i vetvetes, zbulimi i vetvetes, njohja e vetvetes, etj.

Nëpër të shtatë pasqyrat gjejmë rastet kur Koliqi i qaset natyrës me mahnitje fëmijërore; kur e sheh nëpërmjet ndryshimeve në kohë; kur e përdor si instrument për ta bashkërenduar me veprimin ose emocionet, ndjenjat; kur zhytet në pafundësitë e saj; kur e interpreton natyrën me simpati imagjinative apo kur e përdor atë si simbol të shpirtit. Natyra është aq e rëndësishme në korpusin poetik të “Pasqyrat e Narçizit”, saqë elemente të dukshme të saj bëhen subjekte poetike të titujve të shtatë poemthave në prozë: “Ujë e pusit” (pusi), “Pasqyrë e vjetër Shkodrane” (**Shkodra**), “Kroni i Bardhanjorvet” (**kroni**), “Prrue në Dukagjin” (**prroi, Dukagjini**), “Nji çuterr në Helveti” (**Helvetia**), “Vala e detit” (**vala, deti**), “Xhami i dritores s’ime” (**pamja matanë dritares**).

Poemth në prozë pas poemthi në prozë, natyra me pjesë të dukshme e të padukshme të saj vjen edhe si pjesë e bukurisë mbindijore. Umberto Eco sqaron se kjo lloj bukurie u përhap nga neoplatonisti firencez Ficino, sipas të cilit bukuria fiton një vlerë të madhe simbolike, që i kundërvihet konceptimit të bukurisë si përpjesëtim dhe harmoni. Jo bukuria e pjesëve, por ajo bukuria mbindijore, që vihet re në bukurinë ndijore, përbën natyrën e vërtetë të bukurisë. Bukuria hyjnore përhapet jo vetëm në krijesat njerëzore, por edhe te natyra.¹⁶⁰ Është e vështirë të udhëtosh nëpër “Pasqyrat e Narcizit” dhe të mos ndiesh praninë e natyrës, bukurinë e së cilës Koliqi e kthen në një bukurie ndijore, me funksion paralel në lidhje me argumentin që ai shtjellon.

Elementi natyrë zë vend e bëhet edhe më funksional kur plotësohet me elemente vitale floreale apo simbolike si uji. “Modeli hapësinor i makrotekstit, në nivel denotativ, rrjedhën e ujit e ka një ndër elementët ndërtues. Këtij elementi i përgjigjet në nivelin simbolik rrjedha e gjakut shqiptar dhe rrjedha e limfës bimore, të cilat shpeshherë në tekst shkojnë paralel me rrjedhën e ujit.”¹⁶¹ Këtu na duhet të theksojmë edhe se sa e rëndësishme është në këto poemtha në prozë marrëdhënia midis malit dhe detit, e cila lidhet me ujin, rrënjët dhe gjakun, elementet ku mbështetet struktura e gjithë makstrotekstit të Pasqyrave të Narçizit. Këto elemente na dalin gjithnjë të ngërthyera me njëra-tjetrën dhe disa herë narratori poet nuk zgjedh midis tyre.

¹⁵⁹ C. Hugh Holman, W. Harmon, “A handbook to literature”, f. 324-326

¹⁶⁰ Umberto Eco, “Historia e bukurisë”, f. 184

¹⁶¹ Dhurata Shehri, “Koliqi mes malit dhe detit”, fq. 90

Elementi i ujit ka një simbolikë të rëndësishme në procesin e kërkimit dhe gjetjes së vetes sepse bën të mundshëm pasqyrimin, është zbulues dhe i tejdukshëm. Nga ana tjetër duke qenë material i rrjedhshëm dhe gjithnjë në lëvizje, i shkon për shtat ecjes së vazhdueshme të Narçizit për t'u pasqyruar, për të parë fytyrën e tij të vërtetë. Kjo e bën të shkojë jo vetëm drejt ujit, detit, por edhe drejt tokës, gjakut, sepse zhytet në vetvete, në të kaluarën e tij, deri te të parët e tij.

Hipotipoza

Hipotipoza¹⁶² si impakt imazherik lidhet me aftësinë e lexuesit për të krijuar eksperiencën që sugjeron poeti, me anë të përdorimit të përzgjedhur (qëllimisht për të krijuar atë efekt) të gjuhës, që sipas citimit të Eco-s, Dumarsias-i e njëjtëson me imazhin kur pikturohen faktet për të cilat flitet sikur ajo që thuhet të jetë tamam përpara syve, ndërsa Parret-i e sheh si një prej figurave bashkëpunuese për të dhënë sublimen. Më shumë se sa me sugjerimin për t'ia dhënë të gatshme eksperiencën pamore, në këtë rast lexuesi ftohet ta ndërtojë vetë atë.

Lexuesit duhet t'i zgjohet dëshira për të marrë pjesë në këtë ndërtim pamor, pra të futet vetë në lojë. Termi imazh sugjeron diçka të parë, e ndërsa flasim për imazhe në poezi, përgjithësisht i referohemi një fjale apo sekuenca fjalësh, të cilat i referohen çdo eksperience sensoriale¹⁶³ që mund të jetë: shikim, tingull, dëgjim, prekje, imazh perceptues, etj., si p.sh.: aroma, shija, malli, etj. Imazhi realizohet me një fjalë, fjali ose fragment të shkurtër.

Hipotipoza mund të jetë pjesë e një ligjërimi poetik për një qëndrim fizik, një përcjellje ndjesie, një saktësi etj., e realizuar me disa teknika si:

1. Dëshmimi,¹⁶⁴ i cili ka të bëjë me informacionin kryesor p.sh.: karakteristikat fizike të vendit.
2. Detajimi, pasi çdo përshkrim i objekteve pamore është në vetvete hipotipotik dhe hollësitë duhen aq sa për të ndërtuar imazhin, që ndryshe do të thotë nuk duhet të ketë tepri.
3. Lista, listimi i tipareve që nevojiten për të krijuar pamjen.
4. Grumbullimi, i cili e lidh hipotipozën me ritmin. I tillë është p.sh.: grumbullimi i vrullshëm i ngjarjeve.

Hipotipoza duhet të të ndezë dëshirën për të të ndihmuar që të bësh një lidhje, por nuk duhet të ta zbulojë tërësisht pamjen.

- Hipotipoza si përvojë sensoriale – Të ndiesh kërkimin

Te “Xhami i dritores s’ime”, nëpërmjet epifanizimit, ne si lexues ndiejmë se si shpirti i gjërave shpërthen drejt nesh, ato hapin gjirin e tyre më të fshehur drejt nesh. Ato na ofrojnë një realitet “tjetër”, një realitet të dytë. Këtu ndihet i plotë kërkimi, sepse lind nevoja të kërkohet dhe të zbulohet ky realitet i thellë. Narratori-poet bashkë me këtë realitet të thellë të botës, kërkon e zbulon edhe atë të shpirtit të vet, fytyrën e vet të vërtetë.

Mënyra e ardhjes fuqizohet me teknikën e listimit të përmendur më lart, me zgjedhje leksikore si: fushat, malet, pyjet, ograjat, përroi si dhe me anë të teknikës së detajimit të shprehur me zbërthimin e gjendjes së kërkimit të thellë, si dhe me teknikën e grumbullimit, me të cilën rroket: tryeza, libërtorja me shumë rende librash, oda, sendet e odës, oborri, vullajtë e luleve, pusi, pullazet e shtëpive, faqja e një ndërtese t’madhe, majuci i nji kumbonarje, qielli pa re, etj. Kësisoj, natyra bëhet edhe objekt ngjyrash, imazhi ndërtohet në mendje, bëhet spostimi i këtij imazhi në përjetim të gjendjes duke kaluar nga plani konkret tek ai abstrakt, sugjestionues.

¹⁶² Umberto Eco, “Për letërsinë”, f. 176

¹⁶³ X.J. Kennedy, “Literature. An introduction to fiction, poetry and drama”, 4-th ed. Glenview, f. 480

¹⁶⁴ Umberto Eco, “Për letërsinë”, f. 180

- Hipotipoza si imazh viziv – Të ndërtosh pamjen

Kjo lidhet me pamjen që përfytyron dhe percepton lexuesi kur është duke e lexuar për herë të parë tekstin. Është ndërtimi pamor fillestar, projektimi i çastit. Mënyra se si kalohet në plotësim të këtyre imazheve paraprake të parakrijuar në shtrirje kuptimore, fut në lojë imagjinatën dhe mendimin, përmes transmetimit nga emocioni dhe patosi autorial te përjetimi i lexuesit (horizonti i pritjes), duke formësuar letrarisht hipotipozën në disa mënyra interpretuese.

- Hipotipoza si përjetim vetëzbulimi – Të njohësh brendësinë shpirtërore

Si përjetim vetëzbulimi, hipotipoza fillon me teknikën e dëshimit, sipas së cilës poetikisht jepen të dhënat e jashtme, si tronditje e jashtme, për të përgatitur mandej përfytyrimin e së brendshmes me anë të teknikës së detajimit dhe listimit. Këtu autori luan me përfytyrimin e lexuesit, jep dhe fsheh informacion, tërheq dhe shfaq mendim.

- Hipotipoza si përjetim nostalgjik – Të lidhesh me ndjesinë e të shijuarit emocional, për gjëra që nuk rikthehen më ose që rikthehen me ndryshime

Si ndërtim i pasur imazherik është karakteristik për të shtatë poemthat në prozë. Si përjetim nostalgjik po sjellim një fragment të “Ujë e pusit”: *“Mbaj mend një natë kah gjymca e majit. Një natë pá hânë. Shkodrën e kishte mbulue an’ e kand errësija, një errësi e rrasët qi nuk lënte me pá një pëllambë para vetes. Oborri i shtëpís kishte humbë si i mbytur në fundet e një deti në ngjyrë karaboje me gjith manda, me blí shatorr e me tandë. At errësi e dendësonte edhe mâ tepër heshtimi qi mbështielte gjithëshkafen si në një mbulojë të murrinë. Erëza gjethësh e bimësh gufuese, mbi të cilat zotonte fryma nxitëse e lulemustakut, rrijsin si pezull në paluejtësi t’ajris. Pak net mâ përpara nën rrezet e hânës, qi prarojshin kopshtije e mure, lagjet e Shkodrës kumbojshin nëpër valavitje galduese të shrrëgullavet. Tashti qi Shën Gjergji i parë e i dyti kishin kalue, qyteti pushonte në paq të plotë, si i lodhun prej qejfit të valleve.”*¹⁶⁵

Prust-i pranon nga Bergson-i se ekziston një kohë e brendshme (koha e ndërjegjes), në të cilën përputhet e shkuara me të tashmen. Por nëse sipas Bergson-it ndjesitë e rikthyera janë gjithnjë të reja, për Prustin janë po ato; ndërsa për këtë të fundit e kaluara është humbje që nuk mund ta ndalim, për Bergson-in është orteku, përmes të cilit vazhdimisht krijohet vetveten.

Përshkrimi i natyrës nga pozicioni i kthimit në të kaluarën si kujtim ose si ëndërr apo projektion i së ardhmes, shfaqet nga perspektiva të ndryshme narrative, nga kontekste të ndryshme kohore e nga pozicione të ndryshme mentaliteti social e psikologjik. *“E aty në trapazan tash flëjshin mbulue me pluhun vjetërsije sinija e tepsija, legëna e jebrikë rêmi qi dikur dorë nëpër dorë vezulluen ndër darsma e gostina, tue përcjellë me tingull të tyne kumbuer, në të shtruem e në të çuem të sofrave, jonet e qemaneve e të sazeve edhe takllimën e dajreve. Flëjshin minderët me shtroje të zverdhue me tua ândrrue ndoshta mëngjeset kur shtëpija vlonte me farefis, miq, dashamirë e zotnijt me brandavekë të mundafshhtë e çarapë të bardhë e këpucë lustrafini me llastika... Halija me ngjyra të tretuna, ku unë kisha kambët, përkujtonte pashmangët e kuqe me të qindisuna ari, ato pashmangë nusesh e zojash qi e shkelën ambëlsisht kur lajlet e saja shndritshin të reja”*¹⁶⁶

Ndiehet e kaluara si një mallëngjim e frymëzim, duke nxjerrë në pah ndryshimet e dukshme midis së kaluarës dhe së tashmes; një relacion kuptimor e emocional, që vijon të manifestohet edhe në prozat e tjera poetike te “Pasqyrat e Narçizit”.

¹⁶⁵ Ernest Koliqi, Pasqyrat e Narçizit, Vepra 2, Rilindja, Prishtinë, 1996, f. 317

¹⁶⁶ Po aty, fq. 325

- Hipotipoza si saktësi - Imagjinatë e sugjeruar nga rregullsia, grumbullimi, ritmi

Hipotipoza, përveçse si një përcjellje ndjesie, vjen edhe si një saktësi me anë të teknikës së dëshimit, e cila ndihmon për të ndërtuar, imagjinuar pamjen e plotë, duke e ftuar edhe lexuesin ta ndërtojë atë mbi lirinë e fantazisë së kuptimit e interpretimit. E gjithë kjo pjesëmarrje në përjetim, rindërtim, interpretim vjen e nxitur nga procesi i leximit. Pra, te “Pasqyrat e Narcizit”, natyra shfaqet me tërë butësinë e gjallërinë e saj si peisazh duke u bërë pjesë e së bukurës komplekse eksternale, e cila luan rolin e bashkëshoqërueses ose kontrastueses në lidhje me subjektin e përzgjedhur poetik, qoftë personazh, qoftë koncept. Natyra është gjithëherë e pranishme në shtatë poemthas në prozë, duke ndikuar në formësimin e ndjesive më të forta të narratorit-poet si: dashuria, shpresa, jeta, ëndrra, malli, pasiguria, etj.

Elementi natyrë zë vend e bëhet edhe më funksional kur plotësohet me elemente vitale floreale apo simbolike si uji, mali. Përshkrimi i arealit gjeografik artistikisht i përcaktuar por jo gjeografikisht i lokalizuar, vjen e qartësohet pas një numërimi elementesh përbërëse të së tërës, natyrës, e cila përbën shtresimin e saj. Në të gjitha këto raste natyra lidhet pashmangshmërisht me atë fakt që do ndodhë në poemthas në prozë: kujtesë, nostalgji, ëndërr, kërkim, dashuri, zbulim. Në këtë mënyrë, ajo kalon nga të qenit eksternale, e jashtme, në internalitet të “lexuesit”, duke u dhënë poemthas në prozë frymën, gjallimin dhe duke fituar kuptimin e saj metaforik. Ajo kthehet në instrument bashkëveprimi dhe “gjallon” në funksion të faktit poetik, duke e kryer plotësisht funksionin e saj estetik si mjet për zbulim, njohje e përsosje individuale.

Përfundim

Estetika e natyrës te “Pasqyrat e Narcizit” nuk vjen si ornament shtesë zbukures, por si pjesë pa të cilën nuk realizohet kërkimi, zbulimi dhe përkryerja e narratorit-poet. Ajo vjen si një teknikë poetike, e cila na e paraqet natyrën si vazhdimësi lidhjesh, njerëzish, vendesh, objektesh, ndjesish, etj. Konkretisht vjen në funksion të lidhjes me rrënjët, vendin, si plotësim i vetvetes. Në pjesën më të madhe të poemthas në prozë, natyra dhe përshkrimi i pjesëve përbërëse të saj si mal, fshat, shtëpi, përrua, det, etj. vijnë në funksion të ndërtimit dhe njohjes së vetvetes. Por po ashtu edhe duke e përjetësuar Shkodrën si lokalitet gjeografik me ndikim të madh në botën e brendshme të narratorit-poet, në plotësim të ndërtimit të vetes së tij.

Referenca thelbësore ndërtuese të poetikës së “Pasqyrat e Narcizit” janë konceptet: mal dhe det, të cilat shenjojnë truallin, vendin (mali) dhe hapjen ndaj së resë (deti). Poemthas në prozë vijnë të plota edhe në përmasën poetike imazherike, duke iu referuar me këtë kuptimit të eksperiencës sensoriale (shqisore dhe emocionale). Natyra, si element i rëndësishëm te kjo vepër, vjen si eksternalitet me rol aktiv në bashkërendimin me gjendjen emocionale të subjekt-objektit poetik, por edhe si bukuri mbindijore, e cila lidhet në fakt me bukurinë simbolike. Natyra si eksternalitet futet në “Pasqyrat e Narcizit” për t’u bërë internalitet i lexuesit, duke u dhënë poemthas në prozë frymën, gjallimin dhe duke fituar kuptimin e saj metaforik.

Referencat

- [1]. Barthes, Roland. “Aventura semiologjike”, Rilindja, Prishtinë, 1978
- [2]. Berisha, Anton. “Ernest Koliqi, erudit i rrëfimit artistik, në Ernest Koliqi, Vepra 2”, Prishtinë, 1996
- [3]. Dilthey, Wilhelm. “Der Aufbau der geschichtlichen Welt in den Geisteswissenschaften”, Vol.VII of Gesammelte Schriften (Stuttgart, 1958), pp. 192-194, cituar sipas Claus Uhlig në, Literature as Textual Palingenesis: On Some Principles of Literary History
- [4]. Dommermuth-Gudrich, Gerold. “Mitet më të famshme të lashtësisë”, Spektër, Tiranë, 2006
- [5]. Eco, Umberto. “Historia e bukurisë”, Tiranë, DITURIA, 2011
- [6]. Eco, Umberto. “Për letërsinë”, Tiranë, DITURIA, 2007
- [7]. Genette, Gerard. “Palimpsests: Literature in the Second Degree”, Lincoln, NB, University of Nebraska Press, 1997
- [8]. Hamiti, Sabri. “Letërsia moderne shqiptare”, Albas, Tiranë, 2000
- [9]. Hamiti, Sabri. “Studime letrare”, ASHAK, Prishtinë, 2003

- [10]. Heidegger, Martin. "Leksione dhe konferenca", Plejad, Tiranë, 2003
- [11]. Holman, C. Hugh, Harmon W. "A handbook to literature", New York-London, MPC-CMP, 1986
- [12]. Kennedy, X. J., "Literature. An introduction to fiction, poetry and drama", 4-th ed. Glenview, London, Scot Foresman and Company, 1987
- [13]. Koliqi, Ernest. "Kritikë dhe estetikë", Tiranë, 2000
- [14]. Koliqi, Ernest. "Vepra 2", Faik Konica, Prishtinë, 2003
- [15]. Rrahmani, Kujtim. "Intertekstualiteti dhe Oraliteti", AIKD, Prishtinë, 2002
- [16]. Shala, Kujtim. "Shekulli i letërsisë shqipe", Buzuku, Prishtinë, 2006
- [17]. Shehri, Dhurata. "Koliqi mes malit e detit", Onufri, 2006
- [18]. Uelek, Rene & Uoren, Ostin. "Teoria e letërsisë", Rilindja, Prishtinë, 1982